



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

**Zyra e Rregullatorit për Energji**

**Rregulla për vendosjen e çmimeve të gjenerimit  
(Rregulla për Çmimet e Gjenerimit)**

2011



## Përmbajtja

KREU I	Kushtet e përgjithshme	4
Neni 1	Qëllimi dhe fushëveprimi	4
Neni 2	Përkufizimet dhe interpretimet	5
KREU II	Rregullimi i të hyrave të gjeneratorëve të rregulluar	9
Neni 3	Parimet e përgjithshme	9
Neni 4	Shqyrtimet periodike dhe periudhat rregullative	9
Neni 5	Përshtatjet e rregullta	10
Neni 6	Shqyrtimet e jashtëzakonshme	11
KREU III	Të hyrat e lejuara maksimale	12
Neni 7	Parimet e përgjithshme	12
Neni 8	Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes	13
Neni 9	Zhvlerësimi i lejuar	13
Neni 10	Kthimi i lejuar në kapital	14
Neni 11	Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill	14
Neni 12	Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse	15
Neni 13	Kostot e bartshme	15
Neni 14	Alokimi i kostove në komponente fikse dhe variable	16
Neni 15	Zbutja e të hyrave të lejuara	16
KREU IV	Ngarkesat për kapacitet	18
Neni 16	Parimet themelore	18
Neni 17	Procedura e aprovimit të ngarkesave për kapacitet	18
KREU V	Ngarkesat për energji	18
Neni 18	Parimet themelore	20
Neni 19	Procesi i aprovimit të ngarkesave për energji	20
KREU VI	Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	21
Neni 20	Gjuha zyrtare	21
Neni 21	Ndryshimi	21
Neni 22	Interpretimi	21
Neni 23	Shfuqizimi	21
Neni 24	Hyrja në fuqi	21
Shtojca 1	Llogaritja e të hyrave të lejuara maksimale	22
Shtojca 2	Baza e aseteve të tregulluara	27
Shtojca 3	Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit	30
Shtojca 4	Procesi i shqyrtimit periodik	33
Shtojca 5	Procesi i përshtatjeve të rregullta	35



Shtojca 6	Procesi i shqyrtimeve të jashtëzakonshme	36
Shtojca 7	Ngjarja e jashtëzakonshme	38
Shtojca 8	Ngjarjet e forcës madhore	39
Shtojca 9	Aprovimi pas tenderëve konkurrues	40
Shtojca 10	Dispozitat kalimtare	41



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, Nenin 25 dhe Nenin 42, paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, në seancën e mbajtur me 30.09. 2011, miratoi:

## **Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit)**

### **KREU I**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

- 1 Kjo rregull përcakton:
  - 1.1 Bazën për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale që mund të mblidhen nga gjeneratorët e rregulluar brenda një viti relevant, në mënyrë që këta gjeneratorë t'i mbulojnë kostot e arsyeshme të operimit, mirëmbajtjes dhe të investimeve në stabilimentet gjeneruese, me qëllim të furnizimit të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike ("FPEE") në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
  - 1.2 Procesin sipas të cilit do të shqyrtohen dhe ripërcaktohen periodikisht këto të hyra të lejuara maksimale; dhe
  - 1.3 Procesin sipas të cilit do të përcaktohen ngarkesat për energji dhe ngarkesat për kapacitet, të cilat përdoren për mbulimin e të hyrave të lejuara maksimale.
- 2 Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale, ngarkesave për energji dhe ngarkesave për kapacitet, siç sqarohet në pjesën kryesore të kësaj rregulle, vlen në rastin kur çmimi për furnizim nga gjeneratori i rregulluar në FPEE nuk është vendosur përmes një procesi konkurrues tenderimi. Në rastin kur është aplikuar një proces i tillë konkurrues tenderimi, çmimi për furnizim përcaktohet në pajtim me Shtojcën 9.
- 3 Në rastin kur para hyrjes në fuqi të kësaj rregulle ka ekzistuar ndonjë çmim shumëvjeçar apo formulë për llogaritjen e çmimit për furnizim nga gjeneratori i rregulluar për FPEE-në, i aprovuar nga rregullatori, ai çmim apo formulë do të vazhdojë të mbetet në fuqi për afatin në të cilin është miratuar fillimisht. Në rastin kur propozohet që të ndryshohet çmimi apo formula e aprovuar atëherë për përcaktimin e çmimit apo formulës së ndryshuar do të vlejnjë dispozitat e kësaj rregulle.



## Neni 2

### Përkufizimet dhe interpretimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
  - 1.1 “Të hyra të rregulluara aktuale” nënkupton të hyrat që mbulohen nga gjeneratori i rregulluar përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit për FPEE në, si dhe çdo e hyrë tjetër e përcaktuar nga rregullatori, matur në baza akruale;
  - 1.2 “Plani i aprovuar i investimeve” nënkupton programin e projekteve kapitale gjatë periudhës rregullative që aprovohet nga ZRRE në kuadër të shqyrtimit periodik;
  - 1.3 “Kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill” nënkupton kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill sic llogariten në pajtim me Nenin 11, në rastet kur nuk ekziston marrëveshje për furnizim me thëngjill;
  - 1.4 “Caku i disponibilitetit” nënkupton nivelin e caktuar të kapacitetit në dispozicion brenda vitit, i cili përshtatet për mirëmbajtjet e pritshme, daljet e detyruara jashtë sistemit dhe shkaqe të tjera të mosdisponibilitetit;
  - 1.5 “Kapaciteti në dispozicion” nënkupton kapacitetin e gjeneratorëve të rregulluar që është në dispozicion për furnizim;
  - 1.6 “Ditë pune” quhen të gjitha ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas ligjeve në Kosovë;
  - 1.7 “Ngarkesa për kapacitet” nënkupton ngarkesën për njësi të kapacitetit në dispozicion, të përcaktuar në përputhje me Kreun IV;
  - 1.8 “Jetëgjatësia ekonomike” nënkupton jetëgjatësinë që përdoret për llogaritjen e zhvlerësimit të lejuar në bazën e asetëve të rregulluara;
  - 1.9 “Faktori i efikasitetit” nënkupton faktorin e efikasitetit të përcaktuar në shqyrtimet periodike dhe të aplikuar te përshtatjet e rregullta për përcaktimin e kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes të gjeneratorit të rregulluar;
  - 1.10 “Ngarkesa për energji” nënkupton ngarkesën për njësi të furnizuar, të përcaktuar në përputhje me Kreun V;
  - 1.11 “EURIBOR” nënkupton normën e ofrimit për depozita të euros nga Federata Bankare Evropiane për periudhë 3-mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të “Reuters” në ora 11:00 (kohë e matur sipas kohës qendrore evropiane) ose, në rast se “Reuters” nuk vazhdon ta ofrojë këtë shërbim, cilido shërbim tjetër për të cilin pajtohen gjeneratori i rregulluar dhe rregullatorit. Për shmangie të dyshimit, kjo do të jetë normë vjetore;



- 1.12 “Përshtatje e jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.13 “Ngjarje e jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 1.14 “Shqyrtim i jashtëzakonshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 6;
- 1.15 “Kostot fikse” nënkupton kuptimin që i është dhënë në Nenin 14;
- 1.16 “Ngjarje e forcës madhore” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
- 1.17 “Gjenerator” nënkupton stabilimentet gjeneruese të renditura në licencën e gjeneratorit;
- 1.18 “Marrëveshje për furnizim me thëngjill” nënkupton kontratën për furnizim me thëngjill, të nënshkruar ndërmjet pronarit ligjor të gjeneratorit të rregulluar dhe një entiteti tjetër ligjor që është përgjegjës për ta furnizuar me thëngjill gjeneratorin e rregulluar;
- 1.19 “Taksa për licencë” nënkupton shumën për pagesë sipas Nenit 7 të Pasqyrës së Taksave, që lëshohet nga rregullatori dhe mund të amendamentohet;
- 1.20 “Operator i tregut” apo “OT” nënkupton bartësin e licencës për operator të tregut;
- 1.21 “Ngarkesat për operatorin e tregut” ose “Ngarkesat e OT” nënkupton ngarkesat që aplikohen nga OT për kryerjen e shërbimeve të operatorit të tregut;
- 1.22 “Pragu i materialitetit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.23 “Të hyrat e lejuara maksimale” apo “MAR - Maximum Allowed Revenues” nënkupton vlerën maksimale që mund të mbulohet brenda një viti relevant nga gjeneratori i rregulluar përmes ngarkesës për energji dhe ngarkesës për kapacitet, të hyra këto që rregullohen përmes formulave të dhëna në Shtojcën 1 të kësaj rregulle;
- 1.24 “E matur” nënkupton çdo sasi të matur të energjisë elektrike, duke përfshirë këtu matjet për energjinë aktive, energjinë reaktive dhe fuqinë, në pajtim me matësin e instaluar sipas kodit të matjes;
- 1.25 “Vlera neto e tanishme” nënkupton metodën e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë;
- 1.26 “Kostot e bartura” nënkupton kostot e krijuara në përputhje me Nenin 13;
- 1.27 “Faktori profilizues” nënkupton faktorin e përcaktuar në shqyrtimet periodike dhe të aplikuar te përshtatjet e rregullta të kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes, zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar në kapital;
- 1.28 “Propozim” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 4, paragrafi 4;



- 1.29 “Vlerësimi i përkohshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 4, paragrafi 7;
- 1.30 “Furnizuesi publik i energjisë elektrike” ose “FPEE” nënkupton bartësin e licencës për furnizim publik;
- 1.31 “Shqyrtimi periodik” nënkupton shqyrtimin e të hyrave të lejuara maksimale të gjeneratorit të rregulluar për periudhën e ardhshme rregullative;
- 1.32 “Përshtatje e rregullt” nënkupton përshtatjen mekanike të të hyrave të lejuara maksimale që bëhet rreth fundit të çdo viti relevant;
- 1.33 “Gjenerator i rregulluar” nënkupton gjeneratorin që obligohet nga Ligji për Energji Elektrike të furnizojë FPEE-në me çmim të rregulluar, në rastet kur nuk ka konkurrencë të mjaftueshme në tregun me shumicë dhe FPEE-ja kërkon furnizim që t’i përmbushë obligimet e saj;
- 1.34 “Rregullatori” nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji;
- 1.35 “Baza e aseteve të rregulluara” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;
- 1.36 “Periudhë rregullative” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5, paragrafi 3;
- 1.37 “Vit relevant” nënkupton periudhën prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm në mes të përshtatjeve të rregullta;
- 1.38 “Parimet e vendosjes së çmimit të gjenerimit” nënkupton deklaratën e lëshuar nga rregullatori me të cilën duhet të jenë në përputhje ngarkesat e rregulluara për kapacitetet dhe për energji;
- 1.39 “Raport mbi ndikimin financiar” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.40 “Ngarkesat e operatorit të sistemit” ose “Ngarkesat e OS” nënkuptojnë grupin e rregulluar të ngarkesave të aplikuara nga OST për ofrimin e shërbimeve të operatorit të sistemit;
- 1.41 “Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit të rrjetit të transmisionit” apo “Ngarkesa TNUOS” nënkupton ngarkesën e rregulluar nga OST për bartjen e energjisë elektrike përgjatë sistemit të saj;
- 1.42 “Operatori i sistemit të transmisionit” apo “OST” nënkupton bartësin e licencës për operatorin e sistemit të transmisionit;
- 1.43 “Periudha kalimtare” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 10;
- 1.44 “Njësi e furnizuar” nënkupton një MWh;



- 1.45 “Njësitë e furnizuara” nënkupton sasinë e gjithmbarshme të energjisë elektrike që i furnizohet FPEE-së nga gjeneratori i rregulluar, të matur në anën e tensionit të lartë të bllok-transformatorëve të gjeneratorit;
  - 1.46 “Kostot variabile” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 14; dhe
  - 1.47 “Mesatare e ponderuar e kostos së kapitalit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3;
- 2 Termat e tjerë të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.





## **KREU II RREGULLIMI I TË HYRAVE TË GJENERATORËVE TË RREGULLUAR**

### **Neni 3**

#### **Parimet e përgjithshme**

- 1 Gjeneratori i rregulluar duhet të caktojë ngarkesat vjetore të gjenerimit, ashtu që:
  - 1.1 Brenda çdo viti relevant, të hyrat që gjeneratori i rregulluar parashikon të mbledhë nga ngarkesat për kapacitet të jenë të barabarta me komponentin e kapacitetit të të hyrave maksimale të lejuara të aprovuara nga rregullatori;
  - 1.2 Brenda çdo viti relevant, të hyrat që gjeneratori i rregulluar parashikon të mbledhë nga ngarkesat për energji të jenë të barabarta me komponentin e energjisë të të hyrave të lejuara maksimale të aprovuara nga rregullatori;
- 2 Të hyrat e lejuara maksimale do të përcaktohen si vijon:
  - 2.1 Të hyrat e lejuara maksimale dhe kostot për energji do të përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike (Neni 4);
  - 2.2 Para përfundimit të çdo viti relevant do të aplikohet përshtatja e rregullt (Neni 6) që përfshin përshtatjen mekanike të të hyrave të lejuara maksimale për të marrë parasysh ndryshimet në kostot që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të gjeneratorit të rregulluar; dhe
  - 2.3 Shqyrtimet e jashtëzakonshme (Neni 6) që përfshijnë përshtatjen e të hyrave të lejuara maksimale për të marrë parasysh ndryshimet materiale në kosto dhe/ose të hyra që shkaktohen nga një ngjarje e jashtëzakonshme, do të realizohen sipas nevojës.
- 3 Periudha kalimtare, e dhënë në Shtojcën 10, do të aplikohet deri më 31 mars 2016.

### **Neni 4**

#### **Shqyrtimet periodike dhe periudhat rregullative**

- 1 Gjatë shqyrtimeve periodike do të caktohen të hyrat e lejuara maksimale të gjeneratorit të rregulluar për periudhën e ardhshme rregullative.
- 2 Shqyrtimi periodik do të mbahet para çdo periudhe rregullative.
- 3 Çdo periudhë rregullative do të zgjasë 5 vite, përveç:



- 3.1 gjatë periudhës kalimtare të dhënë në Shtojcën 10; dhe
  - 3.2 në rast të pajtimit në mes të gjeneratorit të rregulluar dhe rregullatorit, periudha rregullative mund të shkurtohet apo të zgjatet.
- 4 Formulatat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale në shqyrtime periodike janë dhënë në Shtojcën 1.
  - 5 Procesi për realizimin e shqyrtimeve periodike është dhënë në Shtojcën 4.

## **Neni 5**

### **Përshtatjet e rregullta**

- 1 Gjatë përshtatjeve të rregullta do të llogariten ndryshimet e lejuara të të hyrave të lejuara maksimale.
- 2 Përshtatjet e rregullta do të bëhen para çdo viti të ardhshëm relevant.
- 3 Ndryshimi i të hyrave të lejuara maksimale gjatë çdo përshtatjeje të rregullt do të llogaritet duke u bazuar në:
  - 3.1 Indeksimin e kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes me përmirësimet e prishme të efikasitetit përmes faktorit të efikasitetit;
  - 3.2 Indeksimin e kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (pas aplikimit të faktorit të efikasitetit), zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar në kapital me inflacionin.
  - 3.3 Parashikime të azhuruara të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill, kostove të lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse dhe kostove të bartshme; dhe
  - 3.4 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill, kostove të lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse dhe kostove të bartshme në vitin relevant të tanishëm (të përfunduar tashmë), për shkak të ndryshimeve në mes të volumeve të parashikuara dhe të realizuara të energjisë elektrike të gjeneruar dhe çmimeve të lëndës djegëse.
- 4 Formulatat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale gjatë përshtatjeve të rregullta janë dhënë në Shtojcën 1.
- 5 Procesi për realizimin e përshtatjeve të rregullta është dhënë në Shtojcën 5.



## Neni 6

### Shqyrtimet e jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga ngjarjet e jashtëzakonshme, siç përkufizohen në Shtojcën 7.
- 2 Gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale për pjesën e mbetur të periudhës rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të bëhet përshtatje e jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale. Pragu i materialitetit do të jetë 5%, përveç nëse përcaktohet ndryshe në shqyrtimet periodike me marrëveshje të përbashkët të gjeneratorit të rregulluar dhe rregullatorit.
- 3 Llogaritja e ndikimit mbi të hyrat e lejuara maksimale dhe përshtatjes së jashtëzakonshme nuk duhet të marrë parasysh faktorë të cilët nuk janë të ndërlidhur në mënyrë direkte me ngjarjen e jashtëzakonshme.
- 4 Rregullatori do të marrë parasysh ndikimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në shqyrtimet periodike pasuese.
- 5 Procesi për realizimin e shqyrtimeve të jashtëzakonshme është dhënë në Shtojcën 6.



## KREU III TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE

### Neni 7

#### Parimet e përgjithshme

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale do të caktohen në atë nivel që i mundësojnë gjeneratorit të rregulluar të mbulojë kostot e arsyeshme të furnizimit, përderisa këto kosto të jenë të arsyetuara dhe të vlerësuara me kujdes.
- 2 Kostot e arsyeshme të gjeneratorit të rregulluar do të përfshijnë:
  - 2.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (Neni 8), që do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin dhe faktorin e efikasitetit gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.2 Zhvlerësimin e lejuar (Neni 9), që do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.3 Kthimin e lejuar në kapital (Neni 10), që do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.4 Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill (Neni 11) për ata gjeneratorë që përdorin thëngjillin si lëndë të djegëse, që do të barten në mënyrë të plotë përmes përshtatjeve të rregullta;
  - 2.5 Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë djegëse tjetër (Neni 12) për ata gjeneratorë që kërkojnë përdorimin e lëndëve djegëse (që nuk janë thëngjill) për të startuar gjeneratorin, që do të barten tërësisht gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.6 Kostot e bartura (Neni 13), duke përfshirë ngarkesat e OT-së, OS-së, dhe
  - 2.7 Taksën për licencë, që do të bartet tërësisht gjatë përshtatjeve të rregullta.
- 3 Në vlerësimin e kostove të arsyeshme, rregulatori do t'u referohet këtyre faktorëve, por nuk kufizohet apo limitohet në:
  - 3.1 Informatat ekzistuese të periudhave të kaluara për vëllimin, koston dhe kualitetin e shërbimeve të gjeneratorit të rregulluar;
  - 3.2 Parashikimin rreth vëllimit, kostove dhe kualitetit të shërbimeve të gjeneratorit të rregulluar;



- 3.3 Krahasimet me Kompanitë e ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës; dhe
  - 3.4 Krahasimet me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës.
- 4 Kostot që rezultojnë të arsyeshme do t'u alokohen kostove fikse dhe kostove variabile. Kostot fikse do të mbulohen nga ngarkesat për kapacitet ndërsa kostot variabile nga ngarkesat për energji, siç sqarohet në Nenin 14.

## **Neni 8**

### **Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes**

- 1 Me dorëzimin e vlerësimeve të kostove operative dhe të mirëmbajtjes që duhet të mbulohen përmes të hyrave të lejuara maksimale për çfarëdo periudhe të ardhshme rregullore, gjeneratori i rregulluar duhet të kërkojë të mbulojë vetëm atë pjesë të atyre kostove që mund t'i atribuohen licencës së gjeneratorit të rregulluar.
- 2 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes duhet të përfshijnë vetëm atë komponentë apo element të kostove të korporatës (të ndonjë kompanie amë apo kompanie degë) që mund t'i atribuohet në mënyrë të arsyeshme bartësit të licencës së gjeneratorit të rregulluar duke përdorur praktika normale dhe të zakonshme të kontabilitetit.
- 3 Në çdo përshtatje të rregullt, faktori i efikasitetit duhet të aplikohet te kostot operative dhe të mirëmbajtjes sipas formulave të dhëna në Kreun V.
- 4 Rregullatori duhet ta caktojë faktorin e efikasitetit gjatë shqyrtimeve periodike mbi bazë të përmirësimit vjetor të efikasitetit në kostot operative dhe të mirëmbajtjes së gjeneratorit të rregulluar që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme. Për të shmangur dyshimin, të gjitha fitimet e pritura nga efikasiteti do të përmbliidhen në faktorin e efikasitetit dhe nuk do të llogariten dyfish në parashikimet e kostove operative dhe të mirëmbajtjes.
- 5 Me caktimin e faktorit të efikasitetit, rregullatori duhet t'i referohet, por nuk kufizohet apo limitohet nga faktorët e specifikuar në paragrafin 3 të Nenit 8.

## **Neni 9**

### **Zhvlerësimi i lejuar**

- 1 Kostot e lejuara të zhvlerësimit do të llogariten në mënyrë lineare si funksion i jetëgjatësive ekonomike të aseteve dhe bazës së aseteve të rregulluara për kategori të ndryshme të aseteve, siç përshkruhet në Shtojcën 2.



## **Neni 10**

### **Kthimi i lejuar në kapital**

- 1 Kthimi i lejuar mbi kapital do të llogaritet si funksion i bazës së aseteve të rregulluara dhe mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit, siç përshkruhet në Shtojcën 2 respektivisht në Shtojcën 3.
- 2 Kthimi i lejuar në kapital do të llogaritet bazuar në vlerën e bazës së aseteve të rregulluara në mes të çdo viti relevant (si mesatare e vlerës fillestare dhe vlerës përfundimtare së bazës së aseteve të rregulluara).
- 3 Gjeneratori i rregulluar nuk do të fitojë kthim të lejuar për asetet e financuara nga grantet kapitale.

## **Neni 11**

### **Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill**

- 1 Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill mbulojnë kostot e furnizimit me thëngjill për gjeneratorin e rregulluar. Për të shmangur dyshimin, kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill do të përfshijnë pagesat e taniemës për thëngjill të vendosura nga Qeveria e Kosovës.
- 2 Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill do të:
  - 2.1 Në rastin kur ekziston marrëveshje e furnizimit me thëngjill, caktohen në pajtim me marrëveshjen e aplikueshme; dhe
  - 2.2 Në rastin kur nuk ekziston marrëveshje e furnizimit me thëngjill, llogariten mbi bazë të kostove të supozuara të furnizimit me thëngjill.
- 3 Për shmangien e dyshimit, llogaritja e kostove të parashikuara të furnizimit me thëngjill ndërmerret vetëm për të përcaktuar kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill për qëllimet e përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale për gjeneratorin e rregulluar. Llogaritja nuk paraqet rregullimin e furnizimit me thëngjill nga rregullatori.
- 4 Kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill llogariten duke supozuar se pronësia dhe funksionimi i minierës së thëngjillit në fjalë është një biznes i pavarur, i ndarë nga gjeneratori i rregulluar në fjalë dhe nga veprimtari të tjera të pronarit të gjeneratorit të rregulluar në fjalë.
- 5 Kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill duhet të llogariten në të njëjtën mënyrë si kostot e tjera të arsyeshme të gjeneratorit të rregulluar, që përmban zhvlerësimin e supozuar, kthimin e supozuar në kapital dhe kostot e supozuara të arsyeshme operative dhe të mirëmbajtjes, të cilat që të gjitha do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin gjatë përshtatjeve të rregullta.



- 6 Për qëllimet e llogaritjes së zhvlerësimit të supozuar dhe kthimit në kapital, që do të përfshihet në kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill, baza e asetëve do të llogaritet duke ndjekur të njëjtat parime që aplikohen për llogaritjen e bazës së rregulluar të asetëve të gjeneratorit të rregulluar. Kthimi në kapital do të llogaritet duke përdorur mesataren e kostos së ponderuar të kapitalit që llogaritet duke ndjekur parimet që aplikohen për llogaritjen e kostos së ponderuar të kapitalit të gjeneratorit të rregulluar.
- 7 Gjeneratori i rregulluar dhe rregullatori do të konsultohen me pronarin dhe operatorin e minierës së thëngjillit në fjalë për llogaritjen e kostove të supozuara të furnizimit me thëngjill.

## **Neni 12**

### **Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse**

- 1 Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë djegëse që nuk është thëngjill do të llogaritet si produkti i çmimit të asaj lënde djegëse dhe konsumit të parashikuar të saj.
- 2 Çmimi specifik i lëndës djegëse që nuk është thëngjill do të llogaritet duke marrë parasysh:
  - 2.1 Kostot e realizuara të furnizimit me lëndë djegëse; dhe
  - 2.2 Çmimet e tanishme dhe të parashikuara kombëtare, regjionale dhe ndërkombëtare të lëndës djegëse.
- 3 Konsumi i parashikuar do të llogaritet duke marrë parasysh:
  - 3.1 Konsumin specifik të lëndës djegëse që nuk është thëngjill, që ka për bazë numrin e startimeve ose vëllimin e energjisë së prodhuar; dhe
  - 3.2 Numrin e startimeve apo vëllimin e energjisë së prodhuar, sipas nevojës.

## **Neni 13**

### **Kostot e bartshme**

- 1 Gjeneratori i rregulluar do t'i bartë në mënyrë të plotë të gjitha kostot e bartshme gjatë përshtatjeve të rregullta, të cilat përfshijnë këto në vijim:
  - 1.1 Ngarkesat e faturuara nga OT;
  - 1.2 Ngarkesat e faturuara nga OST; dhe
  - 1.3 Taksën e licencës.



## Neni 14

### Alokimi i kostove në komponentin fikse dhe variabil

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale duhet të alokohen në kosto fikse dhe kosto variabile.
- 2 Kosto variabile janë ato kosto që ndryshojnë me njësitë e furnizuara dhe do të përmbajnë:
  - 2.1 Komponentin variabil të kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes; dhe
  - 2.2 Komponentin variabile të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill.
- 3 Kostot fikse do të llogariten si të hyra të lejuara maksimale minus kostot variabile.
- 4 Komponenti variabil i kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes do të vlerësohet duke iu referuar atyre kostove që nuk do të shkaktoheshin nëse njësitë e furnizuara në cilindo vit relevant do të ishin zero.
- 5 Komponenti variabil i kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill duhet:
  - 5.1 Në rastin kur ekziston marrëveshje furnizimi me thëngjill, të jetë e barabartë me ngarkesën variabile në këtë marrëveshje.
  - 5.2 Në rastin kur nuk ekziston marrëveshje furnizimi me thëngjill, të parallogaritet duke iu referuar atyre kostove të operatorit të minierës së thëngjillit që do të shkaktoheshin nëse volumi i thëngjillit të furnizuar në cilindo vit relevant do të ishte zero.
- 6 Këto parime alokimi përgatiten në përputhje me politikën e Qeverisë së Kosovës për dizajnin e tregut të energjisë elektrike. Nëse më pas bëhen ndryshime në këtë dizajn, atëherë këto parime për alokimin e kostove do të shqyrtohen në përputhje me rrethanat.

## Neni 15

### Zbutja e të hyrave të lejuara

- 1 Gjatë rishikimeve periodike, rregullatori do të zbusë mbulimin e zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar në kapital në atë mënyrë që ato të jenë konstante në secilin vit relevant të periudhës rregullative. Kjo zbutje do të arrihet duke siguruar që vlerat neto të tanishme të zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit në kapital të zbutur apo të pazbutur (gjatë periudhës rregullative) të jenë të barabarta, duke përdorur mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit si normë diskontimi.
- 2 Gjatë rishikimeve periodike, rregullatori mundet gjithashtu të përshtatë profilin e të hyrave të lejuara maksimale gjatë periudhës rregullative, në mënyrë që të minimizojë ndryshime të konsiderueshme në mes të vitit të fundit të periudhës së tanishme rregullative dhe vitit të parë të periudhës së ardhshme rregullative. Rregullatori do t'i kushtojë vëmendje të veçantë





ndikimit që çfarëdo profilizimi do të ketë mbi rrjedhën e parasë së gjeneratorit të rregulluar dhe aftësisë së tij për të furnizuar FPEE-në.

- 3 Ky profilizim shtesë do të bëhet duke aplikuar faktorin profilizues, i cili mund të ndryshojë për secilin vit relevant të periudhës rregullative. Me caktimin e faktorit profilizues gjatë shqyrtimeve periodike, rregullatori do të sigurojë që vlera neto e tanishme e të hyrave të parashikuara të lejuara maksimale (gjatë periudhës rregullatore) të mbetet e pandryshuar, duke përdorur mesataren e kostos së ponderuar të kapitalit si normë diskontimi. Formulatat për aplikimin e faktorit profilizues janë dhënë në Shtojcën 1.



## **KREU IV NGARKESAT PËR KAPACITET**

### **Neni 16**

#### **Parimet themelore**

- 1 Gjeneratori i rregulluar do t'i caktojë ngarkesat për kapacitet në mënyrë që:
  - 1.1 Ngarkesa për kapacitet të mbulojë kostot fikse të gjeneratorit të rregulluar, me kusht që kapaciteti gjenerues në dispozicion të plotësojë cakun e disponibilitetit të caktuar për gjeneratorin e rregulluar; dhe
  - 1.2 Ngarkesa për kapacitet të jetë në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga gjeneratori i rregulluar dhe të aprovuar nga rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me parimet e vënies së çmimeve për gjenerim, të nxjerrë nga rregullatori.
- 2 Ngarkesat për kapacitet do të shprehen në euro për njësi të kapacitetit në dispozicion për orë. Ato do të paguhen në bazë mujore për secilën orë të kapacitetit në dispozicion për atë muaj. Asnjë ngarkesë nuk do të jetë obligative për t'u paguar nga FPEE për orët në të cilat nuk ka kapacitet në dispozicion.
- 3 Rregullatori do të përkufizojë cakun e disponibilitetit që përdoret për të llogaritur ngarkesën për kapacitet brenda çdo viti, që do të marrë parasysh:
  - 3.1 Performancën e kaluar;
  - 3.2 Performancën e parashikuar; dhe
  - 3.3 Krahasimet me gjenerator të ngjashëm në Kosovë dhe gjetiu në Evropë.
- 4 Rregullatori duhet të definojë procedurat për testimin e disponibilitetit të kapacitetit siç është e domosdoshme.

### **Neni 17**

#### **Procedura e Aprovimit të Ngarkesave për Kapacitet**

- 1 Gjeneratori i Rregulluar do të dorëzojë tek Rregullatori Metodologjinë për Ngarkesat për Kapacitet dhe çdo amendamentim të nevojshëm pasues në këtë Metodologji së paku 30 Ditë Pune para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.
- 2 Asnjë Metodologji apo amendamentim i Metodologjisë nuk do të hyjë në fuqi derisa të aprovohet nga Rregullatori.



- 3 Gjeneratori i Rregulluar do të ketë të drejtë të përcaktojë Ngarkesat për Kapacitet, subjekt i kërkesave të Nenit 16 dhe aprovimit të Rregullatorit.
- 4 Palët duhet të kenë të drejtë të apelojnë te Rregullatori rreth Ngarkesave për Kapacitet që u aplikohen atyre, sipas legjislacionit në fuqi.



## **KREU V NGARKESAT PËR ENERGJI**

### **Neni 18**

#### **Parimet themelore**

- 1 Gjeneratori i rregulluar do të caktojë ngarkesat për energji në mënyrë që:
  - 1.1 Ngarkesat për energji të mbulojnë kostot variabile të gjeneratorit të rregulluar, duke pasur parasysh njësitë që priten të furnizohen nga gjeneratori i rregulluar gjatë vitit relevant; dhe
  - 1.2 Ngarkesat për energji të jenë në pajtim me metodologjinë e zhvilluar nga gjeneratori i rregulluar e që aprovohet nga rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në përputhje me parimet për vënien e çmimeve të gjenerimit, të nxjerra nga rregullatori.
- 2 Ngarkesat për energji do të shprehen në euro për çdo njësi të furnizuar.

### **Neni 19**

#### **Procesi i aprovimit të ngarkesave për energji**

- 1 Gjeneratori i rregulluar do të dorëzojë te rregullatori metodologjinë për ngarkesat për energji dhe çdo amendamentim pasues të kësaj metodologjie së paku 30 ditë pune para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.
  - 1 Asnjë metodologji apo amendamentim i metodologjisë nuk do të hyjë në fuqi derisa të aprovohet nga rregullatori.
  - 2 Gjeneratori i rregulluar do të ketë të drejtë të përcaktojë ngarkesat për energji, subjekt i kërkesave të Nenit 18 më lart dhe aprovimit të rregullatorit.
  - 3 Palët do të kenë të drejtë të apelojnë te rregullatori rreth ngarkesave për energji që aplikohen për ta, sipas legjislacionit në fuqi.



## KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 20

#### Gjuha zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

### Neni 21

#### Ndryshimi

1. ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për aprovimin e saj.

### Neni 22

#### Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

### Neni 23

#### Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon “Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve)” dhe “Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të aprovuara më 15 dhjetor 2005, si dhe amendamentimet e bëra më 29 nëntor 2006 në Metodologjinë e Tarifave, të nxjerra sipas Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9.

### Neni 24

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

**Dr. Ali Hamiti, kryesues**

---

**Përparim Kabashi, anëtar**

---

**Blerim Koci, anëtar**



## SHTOJCA 1 LLOGARITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMALE

- 1 Kjo shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të gjeneratorit të rregulluar. Kjo shtojcë ka për qëllim të plotësojë parimet e prezantuara në pjesën kryesore të rregullës.
- 2 Të hyrat e lejuara maksimale ( $MAR_t$ ) do të llogariten gjatë shqyrtimeve periodike dhe përshtatjeve të rregullta sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LGSC_t + OTFC_t + PSTC_t$$

*Ku janë:*

$MAR_t$  Të hyrat e lejuara maksimale a në vitin relevant t (“Maximum Allowed Revenues in Relevant Year t”)

$OPMC_t$  Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t (“Allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t”)

$DEPC_t$  Zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t (“Allowed depreciation in Relevant Year t”)

$RTNC_t$  Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant t (“Allowed return on capital in Relevant Year t”)

$LGSC_t$  Kostot e lejuara të furnizimit të thëngjillit në vitin relevant t (“Allowed lignite supply costs in Relevant Year t”)

$OTFC_t$  Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant t (“Allowed other fuel supply costs in Relevant Year t”)

$PSTC_t$  Kostot e bartshme në vitin relevant t (“Pass-Through Costs in Relevant Year t”)

- 2.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes ( $OPMC_t$ ) do të llogariten gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të formulës në vijim:

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

*Ku janë:*

$OPMC_t$  Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t (“Allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t”)



$OPMC_{t-1}$	<i>Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant –t-1, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik (“Allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t-1”)</i>
$CPI_{t-1}$	<i>Vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, të matur duke përdorur “Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë masë tjetër e inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që lejohet gjatë shqyrtimit periodik (“Actual value of inflation in Relevant Year t-1”)</i>
$E_t$	<i>Faktori i efikasitetit në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik (“Efficiency Factor in Relevant Year t”)</i>
$P_t$	<i>Faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik (“Profiling Factor in Relevant Year t”)</i>

2.2 Zhvlerësimi i lejuar ( $DEPC_t$ ) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të kësaj formule:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

*Ku janë:*

$DEPC_t$	<i>Zhvlerësimi tjetër i lejuar në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative (“Allowed depreciation in Relevant Year t”)</i>
$DEPC_{t-1}$	<i>Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore (“Allowed depreciation in Relevant Year t-1”)</i>
$CPI_{t-1}$	<i>Vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur “Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” publikuar nga Eurostat-i (“Actual value of inflation in Relevant Year t-1”)</i>
$P_t$	<i>Faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“Profiling Factor in Relevant Year t”)</i>



- 2.3 Kthimi i lejuar në kapital ( $RTNC_t$ ) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të kësaj formule:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

*Ku janë:*

$RTNC_t$  *Kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative ("Allowed return on capital in Relevant Year t")*

$RTNC_{t-1}$  *Kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore ("Allowed return on capital in Relevant Year t-1")*

$CPI_{t-1}$  *Vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i ("Actual value of inflation in Relevant Year t-1")*

$P_t$  *Faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik ("Profiling Factor in Relevant Year t")*

- 2.4 Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill ( $LGSC_t$ ) do të llogariten gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të formulës në vijim:

$$LGSC_t = LGSCf_t + (LGSCa_{t-1} - LGSCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

*Ku janë:*

$LGSC_t$  *Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill në vitin relevant t ("Allowed lignite supply costs in Relevant Year t")*

$LGSCf_t$  *Kostot e parashikuara të lejuara të furnizimit me thëngjill në vitin relevant t ("Forecast allowed lignite supply costs in Relevant Year t")*

$LGSCa_{t-1}$  *Kostot e realizuara të lejuara të furnizimit me thëngjill në vitin relevant t-1 ("Actual allowed lignite supply costs in Relevant Year t-1")*

$LGSCf_{t-1}$  *Kostot e parashikuara të lejuara të furnizimit me thëngjill në vitin relevant t-1 ("Forecast allowed lignite supply costs in Relevant Year t-1")*





$I_t$  Norma e interesit për vitin relevant  $t$ , që llogaritet bazuar në EURIBOR plus  $S\%$ , ku  $S$  paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike, që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huat afatgjata mbi normën e EUROBOR-it (“Interest rate for the Relevant Year  $t$ ”)

2.5 Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse (OTFC<sub>t</sub>) do të llogariten gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të formulës në vijim:

$$OTFC_t = OTFCf_t + (OTFCa_{t-1} - OTFCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku janë:

OTFC<sub>t</sub> Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant  $t$  (“Allowed other fuel supply costs in Relevant Year  $t$ ”)

OTFC<sub>f</sub><sub>t</sub> Kostot e parashikuara të lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant  $t$  (“Forecast allowed other fuel supply costs in Relevant Year  $t$ ”)

OTFC<sub>a</sub><sub>t-1</sub> Kostot e realizuara të lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant  $t-1$  (“Actual allowed other fuel supply costs in Relevant Year  $t-1$ ”)

OTFC<sub>f</sub><sub>t-1</sub> Kostot e parashikuara të lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant  $t-1$  (“Actual allowed other fuel supply costs in Relevant Year  $t-1$ ”)

$I_t$  Normën e interesit për vitin relevant  $t$ , që llogaritet bazuar në EURIBOR plus  $S\%$ , ku  $S$  paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatgjata mbi normën e EUROBOR-it

2.6 Kostot e bartshme (PSTC<sub>t</sub>) do të llogariten gjatë përshtatjeve të rregullta me anë të formulës në vijim:

$$PSTC_t = PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku janë:

PSTC<sub>t</sub> Kostot e bartshme në vitin relevant  $t$  (“Pass-Through Costs in Relevant Year  $t$ ”)

PSTC<sub>f</sub><sub>t</sub> Kostot e bartshme të parashikuara në vitin relevant  $t$  (“Forecast Pass-Through Costs in Relevant Year  $t$ ”)



$PSTCa_{t-1}$	<i>Kostot e realizuara të bartshme në vitin relevant t-1 (“ Actual Pass-Through Costs in Relevant Year t-1”)</i>
$PSTCf_{t-1}$	<i>Kostot e parashikuara të bartshme në vitin relevant t-1 (“Forecast Pass-Through Costs in Relevant Year t-1”)</i>
$I_t$	<i>Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatgjata mbi normën e EUROBOR-it</i>



## SHTOJCA 2 BAZA E ASETEVE TË RREGULLUARA

- 1 Kjo shtojcë përshkruan përcaktimin e bazës së aseteve të rregulluara për qëllime të llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar (Neni 9) si dhe kthimit të lejuar në kapital (Neni 10).
- 2 Baza e aseteve të rregulluara do të jetë vlerë rregullative e shumës së aseteve të përdorura dhe të përdorshme të gjeneratorit të rregulluar. Baza e aseteve të rregulluara do të bëjë dallimin në mes të kategorive të ndryshme të aseteve.
- 3 Rregullatori do të përcaktojë vlerën fillestare të bazës së aseteve të rregulluara (më 1 prill 2012) para fillimit të periudhës së parë rregullative.
- 4 Baza e aseteve të rregulluara do të azhurnohet në çdo shqyrtim periodik si më poshtë:
  - 4.1 Kostoja e lejuar e zhvlerësimit gjatë periudhës rregullative të tanishme do të zbritet nga baza e aseteve të rregulluara dhe do të llogaritet në mënyrë lineare, duke përdorur jetëgjatësinë ekonomike të asetit;
  - 4.2 Shitja e aseteve gjatë periudhës së tanishme rregullative do të zbritet nga baza e aseteve të rregulluara bazuar në vlerën e shitjes së tyre;
  - 4.3 Shpenzimet e lejuara kapitale gjatë periudhës së tanishme rregullative do t'i shtohen bazës së aseteve të rregulluara nga data kur asetit vihet në shërbim dhe në koston e lejuar në planin e aprovuar të investimeve. Interesi gjatë ndërtimit do të kapitalizohet. Gjatë shqyrtimeve periodike i licencuari mund të kërkojë që kostoja e realizuar e investimit dhe jo e lejuara t'i shtohet bazës së rregulluar të aseteve. Rregullatori duhet ta pranojë kërkesën nëse i licencuari mund ta demonstrojë në mënyrë të qartë që ndryshimi në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara është si pasojë e faktorëve jashtë kontrollit të të licencuarit dhe që ai i ka bërë përpjekjet më të mëdha për të minimizuar rritjet e kostove. Rregullatori nuk do të bëjë reduktime retroaktive të të hyrave të fituara gjatë periudhës rregullative të tanishme (tashmë të përfunduar) për të marrë parasysh ndryshimet në mes të kostove të lejuara dhe atyre të realizuara. Rregullatori do të marrë parasysh kostot aktuale për shqyrtimet e mëvonshme periodike si mënyrë për parashikimin e kostove të investimeve të ardhshme;
  - 4.4 Nëse një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit nuk vihet në shërbim gjatë periudhës rregullative në fjalë, kostoja e tij e lejuar nuk i shtohet bazës së aseteve të rregulluara në shqyrtimin e ardhshëm periodik dhe të gjitha të hyrat e përfituara nga projekti në periudhën e tanishme rregullative do të zbriten nga të hyrat në periudhën e ardhshme rregullative;
  - 4.5 Në rastet kur kostoja e mirëmbajtjes është apo ka qenë më herët e përfshirë në shpenzimet e lejuara operative, nuk do të lejohet të kapitalizohet apo të përfshihet në bazën e aseteve të rregulluara; dhe



- 4.6 Baza e aseteve të rregulluara do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin përgjatë periudhës së kaluar rregullative, duke përdorur indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në eurozonë, të publikuar nga Eurostat si masë përkatëse.
- 5 Jetëgjatësia ekonomike e aseteve për kategori të ndryshme të aseteve do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në bazën e aseteve të rregulluara. Jetëgjatësia ekonomike do të vlerësohet gjatë shqyrtimeve periodike për të reflektuar jetëgjatësinë teknike të aseteve, përveç në rastet kur ekziston arsye e dëshmueshme se përse jetëgjatësia teknike duhet të ndryshojë nga jetëgjatësia e dobishme ekonomike e asetit.
- 6 Investimet kapitale të aprovuara do të përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike bazuar në planin e aprovuar të investimit për shqyrtimin e ardhshëm periodik. Plani i aprovuar i investimit do të:
- 6.1 Përfshijë projektet kapitale të cilat janë të nevojshme për sigurimin e furnizimeve;
- 6.2 Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
- 6.3 Tregojë përfitimin për konsumatorët e rregulluar që secili projekt kapital pritet të japë;
- 6.4 Ketë parasysh planet e tjera të investimit apo zhvillimore të gjeneratorit të rregulluar që janë aprovuar nga rregullatori (dhe çdo ndryshim në mes të këtyre planeve duhet të identifikohet dhe të sqarohet nga gjeneratori i rregulluar); dhe
- 6.5 Zhvillohet duke përdorur analizë të kostove të diskontuara dhe benefiteve të projektit kapital.
- 7 Plani i aprovuar i investimit do të zbatohet si më poshtë:
- 7.1 Gjeneratori i rregulluar do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar implementimin e planit të aprovuar të investimit sipas orarit të tij të lejuar;
- 7.2 Nëse gjeneratori i rregulluar, për arsye jashtë kontrollit të tij, dështon në implementim të projekteve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në planin e aprovuar të investimit, atëherë gjeneratori i rregulluar duhet ta njoftojë rregullatorin. Gjeneratori i rregulluar duhet të japë arsye të detajuara për vonesën së bashku me orarin e ri;
- 7.3 Gjeneratori i rregulluar mund të aplikojë në çdo kohë te rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me ndonjë projekt tjetër kapital në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet bazës së aseteve të rregulluara në shqyrtimin periodik të ardhshëm. Për shmangie të dyshimit, të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e tanishme nuk do të përshtaten; dhe



- 7.4 Nëse gjeneratori i rregulluar e zëvendëson një projekt kapital në planin e lejuar të investimit me një projekt alternativ para se të marrë aprovimin e rregullatorit, rregullatori do ta marrë në shqyrtim nëse do ta aprovojë zëvendësimin në shqyrtimin pasues periodik por nuk është i obliguar ta bëjë këtë.
- 8 Me qëllim të përcaktimit të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill në rastet kur nuk ka marrëveshje për furnizim me thëngjill, gjeneratori do të përcaktojë bazën e rregulluar të aseteve për biznesin e mihjes së thëngjillit në të njëjtën mënyrë siç është përshkruar më lart, me këto përjashtime:
- 8.1 Rregullatori do të konsultohet me operatorin e licencuar të biznesit të mihjes së thëngjillit për planin e tyre të propozuar të investimit, por rregullatori nuk ka mandat të kërkojë dorëzimin e ndonjë plani të tillë apo ta aprovojë atë;
- 8.2 Bazuar në këto konsultime, rregullatori do të përgatisë vlerësimet e tij për kriteret e projektuara të investimeve të biznesit të mihjes së thëngjillit, me qëllim të përcaktimit të kostove të furnizimit me thëngjill; dhe
- 8.3 Rregullatori do t'i përdorë informatat që i ka në dispozicion për shtesat dhe fshirjet e aseteve nga pasqyrat financiare të publikuara të operatorit të licencuar të biznesit të mihjes së thëngjillit dhe nga konsultimi me operatorin e licencuar për të përcaktuar se cilat shtesa dhe heqje janë bërë me qëllim të azhurnimit të bazës së aseteve të rregulluara pas çdo shqyrtimi periodik.



### SHTOJCA 3 MESATARJA E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT

- 1 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit do të llogaritet mbi bazë paratimore sipas formulave:

$$WACC = (1 - g) * (rE) / (1 - t) + g * (rD)$$

*Ku*

<i>WACC</i>	<i>Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit ("Weighted Average Cost of Capital")</i>
<i>g</i>	<i>Gearing (norma borxh:borxh+ekuitet) ("gearing (debt:debt+equity ratio)")</i>
<i>rE</i>	<i>Kostoja reale e ekuitetit (shprehur si %) ("real cost of equity (expressed as a %")</i>
<i>rD</i>	<i>Kostoja reale e borxhit (shprehur si %) ("real cost debt (expressed as a %")</i>
<i>t</i>	<i>Norma e tatimit mbi korporatat në Kosovë ("Kosovo corporate income tax rate")</i>

- 2 Gearing (g) do të jetë vlerë e propozuar nga gjeneratori i rregulluar dhe e përcaktuar nga rregullatori në mes të 0 dhe 1 dhe përfaqëson pjesëmarrjen e borxhit në financimin e përgjithshëm. Vlera do të përcaktohet mbi bazë të një shqyrtimi të balancuar të përbërjes së financimit të tanishëm të gjeneratorit të rregulluar dhe përbërjes së financimit që mund të pritët të jetë i arritshëm tani dhe në të ardhmen, duke marrë parasysh përbërjen e financimit të kompanive të ngjashme ndërkombëtarisht.

- 3 Kostoja e ekuitetit (rEi) do të jetë vlera që propozohet nga gjenerator i rregulluar dhe përcaktohet nga rregullatori si dhe llogaritet me anë të modelit për vënien e çmimeve të asetëve kapitale (CAPM) me formulën në vijim:

$$rEi = rf + \beta_i * ERPm$$

*Ku janë:*

<i>rf</i>	<i>Norma pa risk ("risk-free rate")</i>
<i>ERPm</i>	<i>Premia për riskun në ekuitet që aplikohet për tërë tregun ("equity risk premium applicable to the market as a whole")</i>
<i>βi</i>	<i>Kovarianca në mes të kthimeve të asetit të ekuitetit në fjalë dhe të asetëve të tregut (beta e ekuitetit) (covariance between the returns on the individual equity asset and those of the market as a whole (the equity beta)</i>



- 3.1 Norma pa risk (rf) paraqet koston e borxhit jokoncesionar shtetëror në Kosovë, në terma realë, që do të propozohet nga gjeneratori i rregulluar dhe do të përcaktohet nga rregullatori duke përdorur të dhëna nga kostoja e borxhit jokoncesionar në Kosovë ose, në rast të mungesës apo pamjaftueshmërisë së kësaj informate, koston e borxhit jokoncesionar shtetëror në shtete të cilat konsiderohen se kanë status të njëjtë kreditor me Kosovën.
  - 3.2 Premia e riskut mbi ekuitetin (ERPm) përcaktohet nga rregullatori duke përdorur të dhëna nga premia e riskut ndërkombëtar të ekuitetit.
  - 3.3 Beta ( $\beta$ ) do të propozohet nga gjeneratori i rregulluar dhe do të përcaktohet nga rregullatori, duke përdorur të dhëna mbi betat e aplikueshme për kompani të ngjashme ndërkombëtarisht.
- 4 Kostoja e borxhit (rD) do të jetë mesatarja e normave të interesit për kreditë ekzistuese afatgjata (që kalojnë 1 vit) për gjeneratorin e rregulluar, shprehur në terma realë dhe ponderuar sipas vlerës në euro të secilës kredi.
- 4.1 Gjeneratori i rregulluar është i obliguar të prokurojë huatë komerciale (jokoncesionare) përmes procesit konkurrues ose t'ia demonstrojë rregullatorit se norma e interesit për huatë që nuk merren përmes procesit konkurrues është e barabartë ose më e ulët se, normat e interesit mbizotëruese në treg në kohën kur është nënshkruar marrëveshja.
  - 4.2 Kur rregullatori konsideron se norma e interesit për një hua të marrë pa prokurim konkurrues e tejkalon normën e interesit të tregut, atëherë ajo hua do të përjashtohet nga llogaritja e koston së borxhit.
  - 4.3 Kur rregullatori konsideron se ka numër të pamjaftueshëm të huave për të arritur në një vlerësim të koston së huamarrjes për OSSH-në, rregullatori mund të përshtatë koston e borxhit të llogaritur si më lart. Kjo përshtatje do të bazohet në:
    - (i) Vlerësimin e normës së interesit në treg për huatë e bizneseve me madhësi, risk dhe status kreditor të ngjashëm me gjeneratorin e rregulluar.
    - (ii) Vlerësimin e normës së parashikuar të interesit për huatë potenciale koncesionare të gjeneratorit të rregulluar.
    - (iii) Vlerësimin e përbërjes së parashikuar të huave komerciale (jokoncesionare) dhe koncesionare në borxhin e gjeneratorit të rregulluar përgjatë periudhës së ardhshme rregullative.
- 5 Për qëllime të përcaktimit të kostove të supozuara të furnizimit me thëngjill, në rastet kur nuk ekziston marrëveshja për furnizim me thëngjill, gjeneratori i rregulluar do ta propozojë dhe rregullatori do ta përcaktojë mesataren e ponderuar të koston së kapitalit në të njëjtën mënyrë si më lart, me këto përjashtime:
- 5.1 Gjeneratori i rregulluar dhe rregullatori do të konsultohen me operatorin e licencuar të biznesit të mihjes së thëngjillit rreth kostove të tyre të financimit;
  - 5.2 Meqë rregullatori nuk ka mandat ligjor të kërkojë që operatori i licencuar të prokurojë huatë përmes procesit konkurrues, gjeneratori i rregulluar do të propozojë dhe



rregulatori do të përcaktojë koston e parallogaritur të borxhit të operatorit të licencuar duke përdorur parimet e njëjta të dhëna në 4.3 të kësaj shtojce; dhe

- 5.3 Gjatë kësaj llogaritjeje, gjeneratori i rregulluar dhe rregulatori do të marrin parasysh çdo evidencë për koston e realizuar të financimit që u prezantohet atyre nga operatori i licencuar.





#### SHTOJCA 4 PROCESI I SHQYRTIMIT PERIODIK

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, rregullatori do të publikojë në ueb-faqen zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet e tjera relevante të pranuar nga gjeneratori i rregulluar apo palët e tjera të interesit që kanë të bëjnë me shqyrtimin periodik brenda një afati të arsyeshëm pas pranimit të tyre dhe rregullatori do të bëjë publike të gjitha informatat materiale që dorëzohen te ai nga gjeneratori i rregulluar, duke përjashtuar informatat që rregullatori i konsideron komercialisht konfidenciale.
- 2 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin periodik jo më vonë se 120 ditë pune para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative.
- 3 Orari për procesin e përgjithshëm të shqyrtimit do t'i dërgohet gjeneratorit gjatë procesit të shqyrtimit.
- 4 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin periodik duke njoftuar gjeneratorin e rregulluar lidhur me:
  - 4.1 Vitet për të cilat kërkohen të dhënat për vitin aktual dhe parashikimet për të ardhmen;
  - 4.2 Formatin në të cilin këto të dhëna do të dorëzohen;
  - 4.3 Orarin për dorëzimin e propozimit të gjeneratorit të rregulluar për të hyrat maksimale të lejuara për shqyrtimin e ardhshëm periodik; dhe
- 5 Propozimi i gjeneratorit të rregulluar do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
  - 5.1 Të hyrat faktike të rregulluara të mbledhura gjatë periudhës së tanishme rregullative (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
  - 5.2 Kostot e realizuara (faktike) të ofrimit të furnizimit gjatë periudhës së tanishme rregullative, në linjë me përkufizimin e kostove që janë përdorur për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale dhe kostove të energjisë;
  - 5.3 Kostot e realizuara të furnizimit me thëngjill gjatë periudhës së tanishme rregullative;
  - 5.4 Raportin vjetor dhe pasqyrat financiare të audituara për secilin vit fiskal që ka përfunduar në periudhën e tanishme rregullative kurdo që këto janë në dispozicion në pajtim me kërkesat e raportimit të licencës së gjeneratorit të rregulluar;
  - 5.5 Nivelin e realizuar të kapacitetit në dispozicion, si dhe njësitë e furnizuara gjatë periudhës së tanishme rregullative;



- 5.6 Parashikimin për kapacitetin në dispozicion dhe njësitë e furnizuara për periudhën e ardhshme rregullative;
  - 5.7 Parashikimin për të hyrat e lejuara maksimale dhe kostot e energjisë, duke raportuar ndaras për secilën komponentë të kostos së lejuar, për periudhën e ardhshme rregullative;
  - 5.8 Kostot e parashikuara të furnizimit me thëngjill për periudhën e ardhshme rregullative;
  - 5.9 Çdo studim të gjeneratorit të rregulluar që mund të ketë ndonjë relevancë me çështjet e ngritura në propozimin e gjeneratorit të rregulluar; dhe
  - 5.10 Çdo material tjetër që rregullatori konsideron se duhet të përfshihet në propozimin e gjeneratorit të rregulluar në rastet kur rregullatori e ka njoftuar paraprakisht dhe me kohë të mjaftueshme gjeneratorin e rregulluar për afatin e dorëzimit të propozimit të tyre.
- 6 Gjatë përgatitjes së propozimit, gjeneratori i rregulluar do të zbatojë plotësisht parimet dhe formulat e kësaj rregulle. Gjeneratori i rregulluar do të deklarojë të gjitha vendet ku nuk janë aplikuar këto parime dhe formula, arsyet për moszbatimin e tyre, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit të përdorimit të qasjes alternative.
  - 7 Pas marrjes së propozimit të gjeneratorit të rregulluar, rregullatori do të vlerësojë saktësinë, relevancën dhe arsyeshmërinë e saj duke aplikuar metodologjinë e kësaj rregulle, duke përfshirë këtu vlerësimin se a reflektojnë të hyrat e lejuara maksimale dhe kostot e energjisë koston e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve të furnizimit.
  - 8 Rregullatori do të përgatisë një vlerësim të përkohshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce), pas konsultimit me gjeneratorin e rregulluar. Vlerësimi i përkohshëm do të paraqesë propozimet e rregullatorit për të hyrat e lejuara maksimale dhe kostot e energjisë që do të mbulohen nga gjeneratori i rregulluar gjatë periudhës rregullative si dhe justifikimin për këtë propozim. Rregullatori, gjatë përgatitjes së vlerësimit të përkohshëm, mund të amendantojë, të ndryshojë apo të fshijë cilëndo pjesë të propozimit të gjeneratorit të rregulluar sipas vlerësimit të tij me kusht që t'i identifikojë këto amendamente, zhvendosje apo fshirje dhe të japë justifikimin për to.
  - 9 Pas përcaktimit të vlerësimit të përkohshëm, rregullatori do të fillojë procesin e konsultimit publik mbi vlerësimin e përkohshëm në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
  - 10 Pas përfundimit të konsultimit publik brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce) para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative, rregullatori duhet të marrë vendimin final për të hyrat e lejuara maksimale dhe kostot e energjisë për periudhën e ardhshme rregullative. Vendimi i rregullatorit do të jetë në pajtueshmëri me këtë rregull.
  - 11 Të hyrat e lejuara maksimale dhe kostot e energjisë siç jepen në vendimin final të rregullatorit, do të aplikohen nga data e fillimit të periudhës së ardhshme rregullative.
  - 12 Gjeneratori i rregulluar mund të apelojë apo kontestojë cilindo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



## SHTOJCA 5 PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA

- 1 Gjeneratori i rregulluar do të dorëzojë te rregullatori propozimin për të hyrat e lejuara maksimale, ngarkesat për kapacitet dhe ngarkesat për energji për vitin e ardhshëm relevant së paku 80 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. Gjeneratori i rregulluar, po ashtu, do të përfshijë në këtë dorëzim edhe dokumentet relevante dhe dëshmitë duke përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me të gjitha komponentët e formulave të përshtatjeve të rregullta të dhëna në Kreun 5, si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga rregullatori.
- 2 Rregullatori mund të kërkojë nga gjeneratori i rregulluar që të japë sqarime shtesë për metodën së tij të llogaritjes së propozimit për të hyrat e lejuara maksimale, ngarkesave për kapacitet, ngarkesave për energji dhe, nëse kërkohet, gjeneratori i rregulluar do të ofrojë, brenda një periudhe të shpejtë kohore, të gjitha informatat dhe shpjegimet e kërkuara nga rregullatori.
- 3 Rregullatori do ta informojë gjeneratorin e rregulluar së paku 60 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant nëse e aprovon ose jo llogaritjen nga gjeneratori i rregulluar të propozimit për të hyrat maksimale të lejuara, ngarkesat për kapacitet dhe ngarkesat për energji.
- 4 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale, ngarkesat për energji dhe ngarkesat për kapacitet, atëherë këto do të jenë të hyrat e lejuara maksimale, ngarkesat për energji dhe ngarkesat për kapacitet për vitin e ardhshëm relevant.
- 5 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale, ngarkesat për energji dhe ngarkesat për kapacitet, rregullatori do të japë arsytim dhe dëshmi për këtë, në pajtim me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale, ngarkesat për energji dhe ngarkesat për kapacitet nuk do të përshtaten derisa rregullatori të aprovojë një propozim alternativ ose të ofrojë llogaritjen e tij për të hyrat e lejuara maksimale.
- 6 Çdo ndryshim në të hyra, që mund të rezultojë nga llogaritja e gabuar, raportimi i gabuar i të hyrave rregullative të realizuara apo kontestimet lidhur me përshtatjen e rregullt, do të mbulohet në vitet relevante vijuese.
- 7 Gjeneratori i rregulluar mund të apelojë apo kontestojë cilindo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



## SHTOJCA 6 PROCESI I SHQYRTIMEVE TË JASHTËZAKONSHME

- 1 Nëse ka ndodhur një ngjarje e jashtëzakonshme, gjeneratori i rregulluar mund të kërkojë shqyrtim të jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda gjashtë muajsh të shqyrtimit periodik apo para përfundimit të shqyrtimit të mëhershëm të jashtëzakonshëm.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një ngjarje të jashtëzakonshme. Në këto raste kjo shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre ngjarjeve.
- 4 Brenda 20 ditëve të punës pas kërkesës së gjeneratorit të rregulluar për shqyrtim të jashtëzakonshëm, gjeneratori i rregulluar duhet të dorëzojë raportin për ndikimin financiar që do të përfshijë çështjet në vijim:
  - 4.1 Përshkrimin e ngjarjes së jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm;
  - 4.2 Përmbledhjen e ndikimit të ngjarjes së jashtëzakonshme në biznesin e gjeneratorit të rregulluar;
  - 4.3 Vlerësimin e ndryshimit në kostot e gjeneratorit të rregulluar në secilin vit nga data e ndodhjes (apo fillimit) të ngjarjes së jashtëzakonshme deri në fundin e periudhës së tanishme rregullative;
  - 4.4 Vlerësimin e ndryshimit në të hyrat e parashikuara që rezultojnë nga ngjarja e jashtëzakonshme në secilin vit nga data e ndodhjes (apo fillimit) të ngjarjes së jashtëzakonshme deri në përfundim të periudhës së tanishme rregullative;
  - 4.5 Llogaritjen e ndikimit financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme në secilin vit, të llogaritur si shumën e ndryshimit në kostot dhe të hyrat e gjeneratorit të rregulluar. Të hyrat do të trajtohen si numra pozitivë dhe kostot do të trajtohen si numra negativë; dhe
  - 4.6 Llogaritjen në lidhje me atë nëse ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se pragu i materialitetit, shumëzuar me të hyrat e gjeneratorit të rregulluar (në vitin para ngjarjes së jashtëzakonshme), shumëzuar me numrin e viteve në mes të datës së ngjarjes së jashtëzakonshme dhe fundit të periudhës rregullative.
- 5 Nëse gjeneratori i rregulluar vlerëson se ndikimi financiar është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë gjeneratori i rregulluar duhet të përfshijë në raportin e tij të ndikimit financiar propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale. Propozimi për përshtatjen e jashtëzakonshme duhet t'u përbahet kushteve në vijim:



- 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë të hyrat e lejuara maksimale në atë mënyrë që vlera neto e tanishme e ndryshimeve të parashikuara të jetë e barabartë me vlerën neto të tanishme të ndikimit financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme duke përdorur mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit si normë të diskontimit;
- 5.2 Koha dhe struktura e përshtatjes së jashtëzakonshme do të shmangë, kur është e mundur, rritjet e menjëhershme të tarifave për konsumatorët (për shembull duke zbutur ndikimin e përshtatjes së jashtëzakonshme përgjatë disa viteve).
- 6 Rregullatori mund gjithashtu të fillojë shqyrtim të jashtëzakonshëm pa kërkesën e gjeneratorit të rregulluar. Në këto raste rregullatori do ta njoftojë gjeneratorin e rregulluar dhe do të përfshijë një përshkrim të ngjarjes së jashtëzakonshme, si dhe një përshkrim të ndikimit të tij të parashikuar. Pastaj, gjeneratori i rregulluar do të përgatisë raportin për ndikimin financiar sipas procesit të përshkruar më lart.
- 7 Rregullatori mund t'i kërkojë gjeneratorit të rregulluar sqarime shtesë për mënyrën e tij të llogaritjes së raportit për ndikimin financiar, si dhe përshtatjes së jashtëzakonshme dhe, nëse kërkohet kjo, gjeneratori i rregulluar do t'i dërgojë rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat dhe shpjegimet shtesë të kërkuara.
- 8 Brenda 20 ditëve pas marrjes së raportit për ndikimin financiar, rregullatori do të njoftojë gjeneratorin e rregulluar nëse e aprovon apo jo propozimin e gjeneratorit të rregulluar për përshtatjen e jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse:
  - 8.1 I plotëson kushtet e përshkruara më lart;
  - 8.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
  - 8.3 Merr parasysh të gjitha informatat materiale në dispozicion gjatë asaj kohe.
- 9 Nëse rregullatori e aprovon përshtatjen e jashtëzakonshme të propozuar, të hyrat e reja të lejuara maksimale do të hyjnë në fuqi menjëherë.
- 10 Nëse rregullatori nuk e aprovon përshtatjen e jashtëzakonshme të propozuar, rregullatori duhet të ofrojë arsyetimin dhe dëshmitë për këtë, në pajtim me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale nuk do të përshtaten derisa rregullatori ta aprovojë një propozim.
- 11 Gjeneratori i rregulluar mund të apelojë apo kontestojë cilindo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



## SHTOJCA 7 NGJARJA E JASHTËZAKONSHME

- 1 Ngjarje e jashtëzakonshme do të jetë ndodhja e ndonjërisht në vijim:
  - 1.1 Çdo ndryshim në normën tatimore duke përfshirë tantimat, të aplikueshme për gjeneratorin e rregulluar që nuk mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve të rregullta;
  - 1.2 Çdo ngjarje e forcës madhore siç përkufizohet në Shtojcën 8;
  - 1.3 Çdo ngjarje tjetër që përmbush të gjitha kushtet në vijim:
    - (i) Nuk ka qenë nën kontrollin e gjeneratorit të rregulluar;
    - (ii) Nuk do të mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve të rregullta; dhe
    - (iii) Do të ndryshojë në masë të konsiderueshme të hyrat dhe/ose kostot e gjeneratorit të rregulluar përgjatë ndonjë periudhe të caktuar 12-mujore, në atë mënyrë që mund të vlerësohet që mund të tejkalohet pragu i materialitetit (i sqaruar në Shtojcën 6).
- 2 Ndodhja e ngjarjes së jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të shkaktuar shqyrtimin e jashtëzakonshëm megjithatë siç përshkruhet në Shtojcën 6, ajo ngjarje duhet të kalojë pragu e materialitetit në mënyrë që të përshtaten të hyrat e lejuara maksimale.



## SHTOJCA 8 NGJARJET E FORCËS MADHORE

- 1 Ngjarje e forcës madhore është ngjarja apo rrethana e jashtëzakonshme që i përfshin të gjitha këto në vijim:
  - 1.1 Është jashtë kontrollit të gjeneratorit të rregulluar;
  - 1.2 Gjeneratori i rregulluar nuk do të mund të kishte krijuar kushte për ta parandaluar;
  - 1.3 gjeneratori i rregulluar nuk ka mundur ta shmangë apo ta tejkalojë; dhe
  - 1.4 Nuk i atribuohet në masë të konsiderueshme gjeneratorit të rregulluar.
- 2 Forca madhore mund të përfshijë, por nuk kufizohet me ngjarjet apo rrethanat e veçanta të paraqitura më poshtë, për sa kohë përmbushen kushtet e lartpërmendura:
  - 2.1 Luftë, gjendje lufte apo veprime ushtarake (pavarësisht se a është deklaruar luftë apo jo), pushtim, akt i armiqve të jashtëm;
  - 2.2 Rebelim, terrorizëm, sabotim nga persona që nuk janë punonjës të gjeneratorit të rregulluar, të kontraktuar apo të nënkontraktuar, revolucion, kryengritje, pushtet ushtarak apo i uzurpuar apo luftë civile;
  - 2.3 Protestë, trazirë, rrëmujë, grevë apo bllokim pune nga persona që nuk janë punonjës, të kontraktuar apo të nënkontraktuar të palës;
  - 2.4 Municione të luftës, materiale eksplozive, rrezatim jonizues apo kontaminim me radioaktivitet, përveç kur këto mund t'i atribuohen përdorimit të palës; dhe
  - 2.5 Katastrofat natyrore si tërmetet apo vërshimet.



## **SHTOJCA 9 APROVIMI PAS TENDERËVE KONKURRUES**

- 1 Në rastet kur çmimet për furnizim të FPEE-së nga gjeneratori i rregulluar janë vendosur përmes procesit konkurrues të tenderimit, rregullatori do t'i aprovojë këto çmime pa iu referuar përcaktimit të të hyrave maksimale të lejuara sipas kësaj rregulle, me kusht që:
  - 1.1 Rregullatori konsideron se konkurrenca në procesin e tenderimit ka qenë efektive.
  - 1.2 Rregullatori ka aprovuar paraprakisht ndonjë formulë për përshtatjen e çmimit në ndonjë kontratë për furnizim të dhënë përmes procesit konkurrues të tenderimit.





## **SHTOJCA 10 DISPOZITAT KALIMTARE**

- 1 Periudha kalimtare fillon nga data 1 prill 2012 dhe zgjat deri më 31 mars 2016.
- 2 Periudha e parë rregullative do të zgjasë 4 vite.